

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

“Konvergenca Ekonomike dhe Sociale: Arritjet aktuale dhe sfidat e ardhshme të reformave në Shqipëri”

Data: 13 Dhjetor 2019 | ora 11:00 – 13:00

Vendi: Libraria Tirana Times

Plani Shumëvjecar i Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor (MAP REA) u miratua në Samitin e Trieste në 2017 dhe përqendrohet në fusha si tregtia, investimet, lëvizshmëria dhe tregu dixhital. Konkurrenca, punësimi, fusha dixhitale dhe bashkëpunimi i të rinjve janë gjithashtu tema kryesore në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2018, ku më konkretisht Iniciativa Flamur e tretë parashikon për “Mbështetjen e axhendës së zhvillimit socio-ekonomik përqendrohet në nxitjen e përparimit në zbatimin e REA, duke përshtatur kornizat ekzistuese për të nxitur investimet në rajon, ..., dhe mbështetjen e arsimit dhe reformave sociale”. Për më tepër, procesi i Specializimit Inteligjent i Shqipërisë aktualisht synon përgatitjen e Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) deri në vitin 2021, duke synuar rritjen ekonomike dhe të vendeve të punës, duke i dhënë përparësi sferës dhe aktiviteteve ekonomike, ne te cilat rajone të ndryshme në Shqipëri kanë një avantazh konkurrues ose kanë potencial për të gjeneruar rritje të bazuar tek dija, si dhe për të sjellë transformimin ekonomik të nevojshëm për të adresuar sfidat kryesore dhe më urgjente për shoqërinë. Koordinimi midis institucioneve të ndryshme dhe një qasje gjithëpërfshirëse duke mobilizuar shoqërinë civile dhe siguruar kontributin e saj kuptimplotë në reformat e përfshira në këto procese, kanë një rëndësi thelbësore për avancimin e axhendës së bashkëpunimit rajonal dhe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror në vend.

Projekti “Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian- CONNECT” është iniciativa më e re e Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim, e cila synon të inkurajojë përfshirjen e shoqërisë civile dhe sidomos të rinjve në dialogun e politikbërjes, si dhe ndërgjegjësimin e përgjithshëm mbi kontributin tyre të vazhdueshëm në procesin e integritimit evropian, veçanërisht gjatë negociatave për anëtarësim.

Në këtë kuadër, Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit organizon tryezën e rrumbullakët “Konvergenca ekonomike dhe sociale: Arritjet aktuale dhe sfidat e ardhshme të reformave në Shqipëri”. Kjo tryezë synon të informojë dhe nxisë një diskutim mbi ecurinë e zbatimit të Zonës Ekonomike Rajonale - REA, të përgatitjes së strategjisë së specializimit inteligjent mbi identifikimin dhe prioritarizimin e investimeve kërkimore, si edhe përcaktimin e një vizioni të përbashkët për inovacionin në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe mbi politikat publike që kanë një fokus të veçantë në fusha si inovacioni, lëvizshmëria e të rinjve dhe akademikëve, dhe punësimi.

Pjesëmarrësit e kësaj tryeze vinë nga rradhët e shoqërisë civile dhe organizatave rinore, akademisë, administratës publike, medias, etj.

Projekti Connect po zbatohet në partneritet me:

AGJENDA

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

“Konvergenca Ekonomike dhe Sociale: Arritjet aktuale dhe sfidat e ardhshme të reformave në Shqipëri”

11:00 – 11:20

Fjala përshëndetëse

Krisela Hackaj, Drejtoreshë Ekzekutive, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Stine Klapper, Drejtore e Zyrës Tiranë, Fondacioni Friedrich Ebert

11:20 – 12.30

Punësimi, Inovacioni dhe Aftësitë: Zhvillimin Social dhe Ekonomik

Paneli:

Linda Pustina, Drejtor i Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Florensa Haxhi, Drejtor për Programet e Zhvillimit dhe Menaxher i Programit për Zonën Ekonomike Rajonale, Zyra e Kryeministrit

Diana Leka, Drejtore e Sekretariatit, Këshilli i Investimeve

Arben Shkodra, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar

Dafina Peci, Drejtoreshë Ekzekutive, Kongresi Rinor Kombëtar

Moderatore: Ornela Liperi, Kryeredaktore e Revistës Monitor

12:30 – 13:00

Diskutim i hapur dhe konkluzione

13:00

Drekë Kokteil

*Kafja do të shërbehet përpara dhe gjatë tryezës.